




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo



Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



Në mbështetje të nenit 11, 12, dhe 40 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna nenit 8 të Rregullores për Transparencë të komunës së Shtërpçës 01-Nr 895 të datës 14.07.2010 e ndryshuar dhe plotësimin me rregulloren nr.01-16-620 të datës 01.03.2013 si dhe nenit 15 dhe 34 të Statutit të komunës së Shtërpçës 01-Nr. 898 të datës 14.07.2010, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 24.04.2022 miratoj këtë:

VENDIM

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË PROPOZIM RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SHTERPCËS

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Shtërpçës dhe si PROPOZIM, vihet në konsultim publik.

Neni 2

Konsultimi publik për “Propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunës së Shtërpçës” do të zgjasë së paku 30 dite nga dita e publikimit të këtij vendimi në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Shtërpçës dhe debati me qytetare do të mbahet më 27.05.2022 ora 11 në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike dhe në Web-faqen e KK të Shtërpçës.

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic

